

Master Profesional në Administrim Biznesi, *profili* “Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore”

Master Profesional në programin “Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore” fokusohet në çështjet reale të biznesit dhe është strukturuar në mënyrë të tillë, që t’i ndihmojë pjesëmarrësit të jenë më krijues në të menduar dhe menaxherë më efektivë. Specializimi në leadership dhe burime njerëzore zhvillon njohuri më të thella të stileve të leadershipit, të cilat ndikojnë si tek individët edhe tek ekipet e punës. Mësimi i mjeteve të nevojshme për të drejtuar një grup, me synim performancën e tij të lartë, përbën një nga çështjet kryesore të marrëdhënieve me stafin.

Kurrikula

- o Menaxhim Strategjik i Burimeve Njerëzore;
- o Sjellje Organizative;
- o Menaxhim i Performancës së Burimeve Njerëzore;
- o Menaxhim i Shpërblimit;
- o Menaxhim Strategjik;
- o Etika e Biznesit.

Karriera

Mundësi punësimi në:

- o institucione të ndryshme publike në nivel qendror dhe lokal;
- o kompani publike apo private;
- o organizata jofitimprurës.



Kohëzgjatja & Forma e studimit

Studime me kohë të plotë

Kohëzgjatja normale e studimeve në program
✓ **1 vit akademik.**

Kohëzgjatja maksimale e studimeve në program
✓ **2 vite akademikë.**

Kriteret

- o Kanë përfunduar dhe janë diplomuar në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licensuar në momentin e regjistrimit të studentit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit;
- o Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të licensuar dhe akredituar dhe diploma e tyre është njehtësuar nga MASR/QSHA.

Dokumentacioni mbështetës për aplikim:

1. Fotokopje Kartë Identiteti / pasaportë;
2. Fotokopje e diplomës së ciklit të parë e noterizuar / diplomë tjetër studimi e fituar jashtë shtetit dhe e njehsuar nga MASR;
3. Vërtetim i listës së notave dhe krediteve / suplementi i diplomës;
4. Fotokopje e noterizuar e diplomës së Maturës Shtetërore + Çertifikatë e notave, e konfirmuar nga DAR/ZA.
5. CV;
6. 2 fotografi;
7. Mandatë pagesa për tarifën e aplikimit të kryer në UniBa.



Kontakte të departamentit:

- ☎ +355 69 20 67 247 | +355 69 20 41 222
- ✉ Email: dept.management@umb.edu.al